

## Komisioni Evropian

[www.europa.eu.int/comm/index\\_de.htm](http://www.europa.eu.int/comm/index_de.htm)



**„Anëtarët e Komisionit ushtrojnë veprimtarinë e tyre në pavarësi të plotë për të mirën e përgjithshme të komuniteteve. Gjatë zbatimit të detyrimeve të tyre ata nuk lejohen të kërkojnë apo pranojnë udhëzime të ndonjë qeverie apo instance tjetër.“**  
(neni 213 (ish-neni157) i Marrëveshjes mbi Komunitetin Evropian)

Komisioni Evropian është pushteti ekzekutues brenda Bashkimit Evropian. Ai detyrohet të garantojë mbarëvajtjen e Unionit si të tërë dhe përgjigjet vetëm para Parlamentit Evropian. Komisioni Evropian ka në thelb katër detyra:

1. i parashtrohet Parlamentit dhe Këshillit propozime për akte të reja ligjore.
2. zbaton politikën e BE-së dhe administrohet buxhetin.
3. kujdeset (së bashku me Gjykatën) për respektimin e të drejtës evropiane.
4. përfaqëson Bashkimin Evropian në nivel ndërkombëtar, p.sh. përmes negociimeve të marrëveshjeve mes BE-së dhe vendeve të tjera.

Duke patur të drejtën e iniciativës Komisioni ka një rol kyç të veçantë brenda për brenda institucioneve të Bashkimit Evropian. Përpara ndërmarrjes së një aksioni të përbashkët apo nisjes së një politike të caktuar, ai është i detyruar të parashtrojë propozimin përkatës me gjykimin, nëse kjo do të ishte e nevojshme për interesat e Bashkimit Evropian.

Gjithashtu nëse Këshilli kërkon, që Unioni të bëhet aktiv në një fushë të caktuar politike, ai duhet t'i kërkojë fillimisht Komisionit të konceptojë propozimin përkatës.

Në kuadër të Politikave të Përbashkëta në Punët e Jashtme dhe Çështje të Sigurisë si dhe në kuadër të Bashkëpunimit në Çështje të Drejtësisë dhe të Politikës së Brendshme në përgjithësi janë Këshilli i Evropës dhe Këshilli i BE-së ata që marrin iniciativën, por Komisioni merr pjesë në punime dhe mund të parashtrojë propozime. Për marrjen e masave koherente në kuadër të politikës së Jashtme, të Sigurisë, të Ekonomisë dhe atyre për Zhvillim së bashku me Këshillin është përgjegjës edhe Komisioni. Këshilli dhe Komisioni bashkëpunojnë në këto fusha dhe garantojnë secili për fushat e veta specifike zbatimin e politikave përkatëse.

Fijet e këtyre proceseve të ndryshme vendimarrjeje mbledhen herë pas here te Komisioni, ndërsa vendimin e fundit, nëse një propozim i Komisionit do të marrë rrugë apo jo e ka shpeshherë Këshilli i BE-së. Komisioni ka detyrën të ndërmjetësojë mes pozicioneve të ndryshme brenda Këshillit apo mes Këshillit dhe Parlamentit. Roli i tij tejet i rëndësishëm bëhet i qartë përmes faktit, që Këshilli mund t'i pranojë propozimet e tij me shumicë të cilësuar – nëse kjo parashikohet me marrëveshje – por mund t'i kthjë mbrapsht vetëm me vendim unanim.

**Fragment nga Preambula e Marrëveshjes mbi BE-në:**

(...) Të VENDOSUR, të ngrenë në një nivel të ri procesin e integritimit evropian iniciuar me themelimin e Komunitetit evropian, DUKE U NISUR nga rëndësia historike e kapërcimit të ndarjes së kontinentit evropian dhe domosdoshmëria e krijimit të bazave të forta për trajtën e Evropës në të ardhmen, DUKE KONFIRMUAR vlefshmërinë e parimeve të lirisë, demokracisë dhe respektimit të të drejtave të njeriut e të lirive themelore, dhe parimit të shtetit ligjor, (...)

ME DËSHIRËN për të përforcuar më tej demokracinë dhe efikasitetin në veprimtarinë e organeve, me qëllim që këto të jenë në gjendje të realizojnë edhe më mirë detyrat e ngarkuara brenda një kuadri të njëzuar institucional (...)

TË VENDOSUR për të vijuar më tej procesin e krijimit të një Unioni gjithnjë e më të ngushtë të popujve të Evropës, ku vendimet të merren sipas parimit të subsidiaritetit duke qenë mundësisht sa më afër qytetarit,

DUKE PATUR PARASYSH që, për të çuar përpara integritimin evropian, duhen bërë hapa të tjerë,

**VENDOSËN të themelojnë Bashkimin Evropian; (...)**

Le të supozojmë për shembull që Komisioni konstaton nevojën e hartimit të akteve ligjore evropiane kundër ndotjes së lumenjve në Evropë. Drejtoria e Përgjithshme për Mjedisin, mbi bazën e konsultimeve të gjera me sipërmarrje evropiane dhe fermerë të ndryshëm, nis punën që së bashku me ministritë e mjedisit në shtetet anëtare dhe organizata të ndryshme mjedisore të hartojë propozimin përkatës. Projekt-propozimi diskutohet më pas me sektorët e tjerë të Komisionit dhe shqyrtohet nga Drejtoria Juridike dhe Sekretaria e Përgjithshme.

Sapo propozimi të jetë gati ai vendoset në rendin e ditës së seancës së ardhshme të Komisionit. Nëse gjatë procesit të votimit ai merr 14 nga 27 votat e anëtarëve të Komisionit, konsiderohet si i pranuar nga Komisioni dhe merr kështu mbështetjen e pakufizuar të të gjithë kolegiumit. Dosja i dërgohet më tej Këshillit dhe Parlamentit Evropian për raportim.

Komisioni Evropian mund të ngarkohet edhe me realizim bisedimesh. Kështu Komisioni mund të lidhë për shembull marrëveshje tregtare në emër të BE-së me shtete të treta ose mund të drejtojë bisedimet rreth marrëveshjeve të tilla të tregtisë.

Në disa fusha politike specifike, si p.sh. politika agrare dhe politika e konkurrencës, Komisioni ndërmerr detyra ekzekutive. Në këtë mënyrë ai është përgjegjës për zbatimin e rregullave apo politikave të Komunitetit.

Komisioni duhet të verifikojë, nëse respektohet dhe zbatohet siç duhet e drejta komunitare për të cilën është rënë dakord. Për këtë motiv ai shihet edhe si roja i marrëveshjeve. Në këtë kontekst Komisioni ka të drejtën, që në rast konstatimi se një shtet anëtar ka shkelur të drejtën komunitare, të ngrëjë padi pranë Gjykatës Evropiane.

Komisioni ka në dispozicion instrumenta të ndryshme për arritjen e objektivave të tij kështu ai ka të drejtën të parashtojë në Këshill dokumenta strategjikë, t'i japë rekomandime dhe të dërgojë atje njoftime, të lidhë marrëveshje ndërkombëtare dhe të koordinojë ndihmën humanitare.

Aktualisht Komisioni Evropian përbëhet nga Kryetari i Komisionit dhe 26 komisionerë të tjerë. Secili prej komisionerëve mbulon një fushë të caktuar politike. Vendimet merren bashkarisht me shumicë absolute. Komisioni i nënshtrohet miratimit nga Parlamenti Evropian. Mandati i tij zyrtar zgjat pesë vjet.

Një komision me 27 anëtarë nuk mund të punojë pa patur probleme. Ky numër është përcaktuar njëzëri nga Këshilli. Por pas anëtarësimit të shtetit të 27-të do të duhet që pas fillimit të detyrës nga Komisioni i ardhshëm (parimisht që prej nëntorit 2009) numri i komisionerëve të reduktohet. Madhësia përfundimtare e Komisionit duhet të vendoset nga Këshilli. Komisionerët do të veprojnë pastaj sipas parimit të rotacionit, ku duhet bërë kujdes që vendet të përfaqësohen në mënyrë transparente. Në këtë kontekst duhet garantuar, që spektri demografik dhe gjeografik i tërësisë së shteteve anëtare të reflektohet në përbërjen e Komisionit.

Në sektorin e politikave të zgjerimit të BE-së Komisioni luan një rol shumë të veçantë. Komisioneri i zgjerimit është në praktikë përgjegjës për procesin e përgatitjes dhe bisedimet e anëtarësimit dhe përgjegjës për të gjitha marrëdhëniet dypalëshe me vendet që kanë bërë një kërkesë anëtarësimi. Ai angazhohet për suksesin e procesit të zgjerimit në interes të të gjithë Unionit. Ndaj për të do të ishte e rekomandueshme të ruante kontakte të mira si me përfaqësuesit e vendeve kandidatë për anëtarësim ashtu edhe me institucionet evropiane. Me të parët për t'i mbështetur në procesin e integritimit, me të tjerët për të sjellë dhe reklamuar zgjidhje, që nxisin integritimin.

Për të arritur këtë qëllim, Ju si Kryetar Komisioni dhe komisioner keni në dispozicion disa mjete të caktuara (në varësi të vlerësimit Tuaj personal):

- Jeni apo do të jeni njohës i mirë i progresit dhe problematikave në vendet kandidatë për anëtarësim.
- Jeni ekspert në bisedat joformale me Ministrat dhe parlamentarët.
- Përpiqeni të ndikoni përfaqësuesit e shtypit.
- Për të patur mbështetjen e popullit Tuaj Ju nisni një fushatë të gjerë shtypi.
- U luteni herë pas here partnerëve Tuaj, pjesëmarrës në bisedime, për bashkëpunim konstruktiv.
- I parashtroni vetë Këshillit dhe Parlamentit propozime, që megjithë interesat e ndryshme të mund të keni miratimin e vendeve dhe fraksioneve përkatëse.

Për kujtesë: Cili është roli i Komisionit Evropian në procesin e zgjerimit?

#### **Neni 49 (Ex-Artikel O) Marrëveshja mbi BE – pranimi i shteteve të tjera anëtare**

„Çdo shtet evropian [...] mund të bëjë kërkesën për t'u anëtarësuar në Bashkimin Evropian. Kërkesa i dorëzohet Këshillit, i cili duhet të vendosë njëzëri pasi ka dëgjuar Komisionin dhe ka marrë miratimin e Parlamentit Evropian, i cili, nga ana e tij merr vendimin e vet me shumicë absolute (shënim i autorit: të paktën 50 % +1 të të gjithë deputetëve).”

#### **Detyrat Tuaja si Kryetar i Komisionit ose Komisioner për Zgjerimin**

1. Me një fjalim të përgatitur deklaroni të hapur simulimin
2. Përcaktoni pozicionin Tuaj me ndihmën e profilit të roleve, të fjalës së hapjes dhe të informacioneve rreth vendeve kandidatë.
3. Diskutoni dhe miratoni një rregullore të brendshme (rrjedha e seancës, mbajtja e protokollit etj).
4. Nga Kryetari i Këshillit të Bashkimit Evropian Ju dorëzohen kërkesat për anëtarësim të vendeve kandidatëve;
5. Nga Këshilli i Bashkimit Evropian ngarkoheni të paraqisni një pozicion Tuajin në lidhje me kërkesat.
6. Zhvilloni biseda personale informative me vendet kandidatë për anëtarësim.

7. Konceptoni një qëndrim Tuajin në lidhje me Kërkesat për anëtarësim të vendeve kandidate: përshkruani situatën politike dhe ekonomike të këtyre vendeve, evidentoni problemet gjatë bisedimeve për anëtarësim, rekomandoni hapjen e negociatave, konceptoni dhe realizoni një anketim mes kandidatëve (*fakultative*) (formular anketimi rreth temave të mësipërme).
8. I prezantoni Këshillit të Bashkimit Evropian pozicionin Tuaj.
9. Këshilli i Bashkimit Evropian Ju ngarkon me realizimin e bisedimeve.
10. Formuloni Marrëveshjen e Anëtarësimit
11. Dërgoni ftesat për në „konferencën përmbyllëse“.
12. Përgatisni fjalën përmbyllëse të Kryetarit/es.

E rëndësishme: Komisioni është ndërmjetës mes Këshillit dhe Parlamentit; ai duhet të informojë në mënyrë të vazhdueshme Parlamentin në lidhje me vijimësinë e bisedimeve.

**Në realitet Marrëveshjet e lidhura u përcillen vendeve anëtare të BE-së (pra ministrave) për ratifikim nga organet kushtetuese të vendeve përkatëse anëtare. Ky hap nuk përfshihet në simulim.**

## Fjala e Kryetarit/es së Komisionit



Bruksel, më

### Komisioni Evropian

„Shumë të nderuar zonja/zotërinj Ministre/a,  
Shumë të nderuar zotërinj deputetë,  
shumë të nderuar zonja dhe zotërinj,

është kënaqësi për mua t'ju përshëndes në këtë moment festiv në Bruksel. Ne presim shumë nga Konferenca dhe bisedimet, që kemi përpara.

Në vitin 2004 dhjetë shtete të Evropës Qendrore dhe Lindore u anëtarësuan me sukses në Bashkimin Evropian. Në vitin 2007 vijoi anëtarësimi i Bullgarisë dhe Rumanisë. Tani na presin bisedime të tjera me shtatë shtete të Ballkanit Perëndimor dhe me Turqinë.

Zonja dhe zotërinj, tanimë varet nga Ju të përfundojmë këtë proces përafrimi që e kemi sjellë kaq përpara. Që zgjerimi duhet të realizohet, për këtë bëhemi gjithnjë e më të vetëdijshëm me kalimin e kohës. Është detyra Juaj të vendosni se në cilin moment dhe sa banesa të reja i duhen shtuar Shtëpisë Evropiane. Sigurisht që kjo kërkon disa etapa të realizohet, dhe disa vende do të hyjnë më shpejt se disa të tjera.

Ngritja e një Komuniteti për Paqe, Stabilitet dhe Mirëqenie ishte vizioni i etërve të themelimit të BE që përpara pothuaj 60 vjetësh. Dhe ky ideal evropian ka rëndësi të madhe për qytetarët tanë – sot po aq sa dikur. Pra në nuk mund të ulemi e të pushojmë mbi ato që kemi arritur. Konfliktet e tmerrshme të viteve të fundit kanë sjellë luftë, dëbime dhe vuajtje të pamatëshme mbi njerëzit e ish-Jugosllavisë. Ne, vendet e BE-së, duam t'i kapërcejmë bashkarisht këto përvoja të tmerrshme dhe të bashkohemi me vendet e Ballkanit dhe Turqinë në lidhje edhe më të ngushta të një komuniteti vlerash demokratike.

Mendoj, që nuk duhet t'i privojmë fqinjët tanë nga mundësia për tu bërë pjesë e projektit evropian. Sepse në Evropë vazhdon të ketë pasiguri, probleme ekonomike dhe varfëri. Po kështu nuk duhen mbyllur sytë përpara nacionalizmit në rritje dhe mungesës së respektimit të të drejtave të minoriteteve kombëtare. Në këtë botë rrjetesh nga më të ndryshmet në epokën e globalizimit nuk mjafton të zgjidhen vetëm problemet para portës së shtëpisë tënde. Ato kërkojnë bashkëpunim – edhe bashkëpunim evropian!

Për ne është një detyrë e domosdoshme, ta bashkojmë dhe zgjerojmë më tej shtëpinë evropiane, dhe kjo detyrë ndodhet tani në duart Tuaja! Jeni Ju, që vendosni se në cilin moment dhe për cilat vende do të jetë i mundur anëtarësimi në Bashkimin Evropian!

Përes zgjerimit të tij në drejtim të Juglindjes Bashkimi Evropian do të jetë më i pasur e më i larmishëm me identitete kulturore dhe rajonale. Ky proces historik zgjerimi ofron mundësinë unike, që për gjithë Evropën të krijohet një „arkitekturë e re“, në të cilën paqja dhe siguria mund të sjellin partneritetin e kulturave, ndërsa „luftës së kulturave“ do t'i jepet përfundimisht një përgjigje negative.

Të gjithë ne po ndiejmë ndërkohë erën që na fryn kundër, e cila po bëhet gjithnjë e më e fortë. Kudo dëgjojmë më i fortë zëri i skeptikëve, që flasin kundër Evropës dhe kundër zgjerimit duke u nisur nga padija, frika dhe paragjykimet. Rreziqet dhe problemet nuk duhen mbajtur fshehur, përkundrazi duhen tematizuar dhe zgjidhur. Por një gjë është e sigurt: Rreziku më i madh për të ardhmen e Evropës në paqe dhe siguri do të ishte humbja e kësaj mundësie historike për bashkimin e mëtejshëm të kontinentit tonë, sepse në metrat e fundit na mungoi guximi.

Prandaj Ju lutem për bashkëpunim konstruktiv me Komisionin dhe u bëj thirrje të dyja palëve, BE-së por edhe vendeve kandidate, të shfrytëzojnë në mënyrë energjike kohën që kemi, të ruajmë ritmet dhe të mobilizojmë forca të reja, me qëllim që objektivi ynë i përbashkët të mund të arrihet.

Më lejoni tani t'Ju ftoj të filloni punën me këshiillimet brenda komisioneve Tuaja dhe t'Ju uroj shumë sukses në bisedime! Zonja dhe zotërinj, Ju falënderoj për vëmendjen."